


# ANGAZHIMI PËR VEPRIM TË PËRBASHKËT - EJA KOSOVË

UDHËZUESI PËR PROCEDURËN E NOMINIT PËR ÇMIMIN PËR DEMOKRACI

Bashkëfinancuar nga:



Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



## Hyrje

Angazhimi për Veprim të Përbashkët (EJA Kosovë) është program i KCSF-së që mbështet nismat e shoqërisë civile përmes granteve dhe ngritjes së kapaciteteve me synimin e përgjithshëm për të dhënë kontribut domethënës në zhvillimin demokratik dhe socio-ekonomik të Kosovës. E themeluar si mekanizëm i financimit ku disa donatorë i bashkojnë fondet e tyre për përkrahjen e shoqërisë civile, EJA Kosovë aktualisht financohet bashkërisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia.

Duke vënë në plan të parë angazhimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në punën e shoqërisë civile, EJA Kosovë synon të kontribuojë drejt dy objektivave kryesorë (a) rritjes së angazhimit të qytetarëve në jetën publike përmes avokimit me pjesëmarrje të shoqërisë civile dhe (b) t'u mundësohet OSHC-ve që t'i forcojnë marrëdhëniet e tyre me qytetarët dhe t'i përmirësojnë kapacitetet organizative.

EJA Kosovë bazohet në premisën që përmes sistemeve të përshtatura të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies nga njëra anë, dhe qasjes dhe komunikimit më të mirë me komunitetin, nga ana tjetër, OSHC-të, duke i përfshirë qytetarët në punën e tyre, mund të ndërtojnë bazë më të fortë dhe më të angazhuar të mbështetjes. Kjo forcon qytetarët dhe mundëson që ato t'i përfaqësojnë më mirë nevojat dhe shqetësimet e komunitetit. Së bashku me qeverisje të brendshme, transparencë dhe angazhim më të mirë të qytetarëve, kjo do të kontribuojë në rritjen e besimit publik në OSHC-të. Qytetarët i shohin ato si platformë legjitime dhe efektive për ngritjen e shqetësimeve dhe avokimin për ndryshim.

Pikëpamja tradicionale e politikëbërjes fokusohet në proceset formale ligjore dhe normative. Megjithatë, politikëbërja efektive shtrihet përtej këtyre strukturave. Ajo përfshin të gjitha aspektet e shoqërisë dhe jetës publike, duke siguruar që zërat dhe nevojat e të gjithë qytetarëve të dëgjohen dhe të merren parasysh. Çdo burrë dhe grua, djalë dhe vajzë kosovare duhet të ketë mundësinë që t'i adresojë nevojat, shqetësimet dhe propozimet e tij/saj në mënyrën më adekuate për kapacitetet, nevojat dhe kontekstin e tij/saj. Shoqëria civile ka mundësi, por edhe përgjegjësi, për t'i fuqizuar qytetarët dhe për t'i sjellë shqetësimet dhe zërin e tyre në qendër të vëmendjes së politikave publike dhe diskursit publik.

## Instrumentet mbështetëse të EJA Kosovë

Duke njohur diversitetin e shoqërisë civile dhe qasjet e saj të ndryshme, EJA Kosovë fokusohet veçanërisht në nismat dhe individët që përfshijnë në punën e tyre praktikën me pjesëmarrje. Ky fokus bazohet në besimin se shoqëria civile mund t'u përgjigjet vërtet nevojave të qytetarëve vetëm duke i përfshirë ata në mënyrë sistematike dhe të qëllimshme në aktivitetet e saj. Një përfshirje e tillë jo vetëm që rrit ndikimin, transparencën dhe llogaridhënien, por gjithashtu përmirëson praktikën e qeverisjes së brendshme përtej thjeshtë punës me dokumente. Duke u mbështetur në kapacitetet dhe përvojën ekzistuese brenda shoqërisë civile, EJA Kosovë synon ta ngushtojë hendekun ndërmjet shoqërisë civile dhe qytetarëve, duke rritur kështu legjitimitetin dhe ndikimin e saj.

Për t'i mbështetur këto synime, EJA Kosovë ofron disa mekanizma mbështetës: Grante Institucionale, Grante për Zhvillim Organizativ, Grante për Projekte, Grante Urgjente dhe Çmimin Vjetor për Demokraci. Çdo instrument është dizajnuar për të adresuar nevoja specifike brenda shoqërisë civile, duke siguruar që një spektër i gjerë nismash mund të gjejë mbështetjen që u nevojitet.

## Çmimi për Demokraci

Çmimi për Demokraci ka për qëllim të vlerësojë kontributet e individëve, nismave të pargjistruara dhe të organizatave jo-qeveritare në fusha të ndryshme, që janë rezultat i mobilizimit të komunitetit dhe angazhimit të qytetarëve, guximit intelektual ose arritjeve të theksuara, dhe që kanë kontribuar në demokratizimin e shoqërisë kosovare përmes punës dhe përkushtimit të tyre, si dhe nëpërmjet shembujve konkret të angazhimit qytetar shembullor të sjellë në vëmendjen e publikut dhe vendim-marrësve tema, çështje, grupe qytetarësh ose subjekte të nën-përfaqësuar në jetën publike dhe vendim-marrjen institucionale.

## Kriteret për nominim

Kush mund të nominohet?

- ✓ Të drejtën për t'u nominuar e kanë të gjitha organizatat jo-qeveritare, nismat e pargjistruara dhe individët të cilët me punën dhe përkushtimin e tyre kanë dhënë kontribut në demokratizimin e shoqërisë kosovare.
- ✓ Të nominuarit nuk duhet të jenë/të udhëhiqen nga Persona të Ekspozuar Politikisht (PEP)<sup>1</sup>.
- ✓ Të nominuarit nuk duhet të kenë pasur aktivitet që qartazi bie ndesh me Vlerat Themelore të KCSF-së për grantistët e programit EJA Kosovë<sup>2</sup>.

Përfitues të Çmimit për Demokraci **nuk mund** të jenë:

- a) Organizatat/nismat e pargjistruara/individët të cilët për kauza të njëjta janë përkrahur financiarisht nga KCSF në tri vitet e fundit (2021, 2022, 2023);
- b) Nismat e njëjta ose shumë të ngjashme me ato të cilat janë shpërblyer me Çmimin për Demokraci gjatë tri viteve të fundit (2021, 2022, 2023);
- c) Organizatat/nismat e pargjistruara/individët të cilët aktivitetet për të cilat janë nominuar i kanë qartë pjesë të përgjegjësive të punës për të cilat paguhen ose obligime e detyra themelore të mandatit zyrtar të pozitës që e mbajnë.

## Kush mund të nominojë?

Nominimet mund t'i paraqesë cilado organizatë, subjekt apo person që ka informata të sakta dhe të detajuara mbi nismën e nominuar. Të interesuarit mund të nominojnë edhe vetveten.

## Kriteret e përzgjedhjes

Të gjitha nominimet do të shqyrtohen veç e veç dhe do të vlerësohen nga Ekipi për Vlerësimin e Granteve (EVG), bazuar në këto kriteret:

- ✓ Dizajnimi dhe zbatimi i një nisme të suksesshme (qasje, aktivitet, projekt, etj.) në promovimin dhe zhvillimin e demokracisë në Kosovë, gjatë vitit 2024;
- ✓ Niveli i nën-përfaqësimit të temës, çështjes, grupit të qytetarëve, ose subjektit bartës të nismës së nominuar;
- ✓ Ndikimi aktual ose i pritur i kësaj nisme, duke përfshirë potencialin për zgjerim/përsëritje dhe inovacionin;
- ✓ Guximi i organizatës, nismës së pargjistruar a individit shprehur përmes nismës përkatëse;
- ✓ Përfshirja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në nismë ose kontributi i theksuar i pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike dhe/ose politikëbërje.

1 Për më shumë rreth kufizimeve në lidhje me personat e ekspozuar politikisht (PEP), shih formularin për nominim.

2 Për më shumë rreth Vlerave Themelore të KCSF-së për grantistët e programit EJA Kosovë, shih formularin për nominim.

## Procesi i nominimit

Për të kompletuar procesin e nominimit, sigurohuni që keni plotësuar dhe dorëzuar dokumentet vijuese:

- 1)** Formularin për nominim të plotësuar;
- 2)** Dokumentet përcjellëse (artikuj të shkruar, mjete verifikimi dhe referenca për nismën e nominuar, etj.);
- 3)** Për organizata jo-qeveritare, një kopje të certifikatës së regjistrimit; Për nismat qytetare një dëshmi mbi funksionimin e nismës<sup>3</sup>. (Dokumentet duhet të jenë të subjekteve të nominuara, jo të nominuesve).

## Dorëzimi i dokumentacionit

Formulari për nominim së bashku me dokumentet plotësuese duhet të dërgohen në formë elektronike në formatin Word ose PDF në [ej@kcsfoundation.org](mailto:ej@kcsfoundation.org) jo më vonë se **14.02.2025, ora 23:59**.

## Nominimet e dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Kjo thirrje për nominime nuk parasheh ofrimin e përgjigjeve individuale dhe dhënien e arsytimit për nominimet që nuk përzgjidhen. Vetëm nominuesit e suksesshëm do të njoftohen për vendimin, dhe atë pas përfundimit të gjithë procesit të vlerësimit. Gjatë procesit të vlerësimit palët nuk duhet të kontaktojnë KCSF-në mbi statusin e nominimit të tyre.

---

<sup>3</sup> Çfarëdo dokumenti që dëshmon ekzistencën e nismës p.sh: lista e anëtarëve, foto, materiale nga aktivitetet/takimet, etj.